


Raport analitik

PERFORMANCA E LEGJISLATURËS SË TETË TË KUVENDIT TË KOSOVËS

(mars 2021 – dhjetor 2024)

Dhjetor 2024





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2024. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Autore: Violeta Haxholli

Hulumtimin e asistuan monitorueset e Kuvendit, Fjollë Haziri, Ema Krasniqi dhe Yllka Kllokoqi.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239

10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Shënim: Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit "Të rinjtë dhe Shoqëria Civile për Integritet" Eng: (Youth and Civil Society for Integrity), i cili financohet nga Qeveria Suedeze, përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe jo doemos reflekton qëndrimet e donatorit.



PËRMBAJTJE

06

PËRMBLEDHJE
EKZEKUTIVE

09

HYRJE

10

KONTEKSTI POLITIK

12

ECURIA E PUNËS
PARLAMENTARE

Zhvillimet në Kryesi

Zhvillimet në Seanca

Në mungesë të
kuorumit

Pa Kod të Sjelljes, e me
sjellje jo parlamentare

17

LIGJVËNIA DHE NATYRA E
LIGJEVE TË MIRATUARA

Kontestimi i ligjeve në
Gjykatën Kushtetuese

21

MBIKËQYRJA
PARLAMENTARE

Mbikëqyrja e zbatimit të
ligjeve

Prezenca dhe raportimi i
ministrave në Komisone
Parlamentare

Mbikëqyrja përmes
komisioneve hetimore

24

PUNA E KOMISIONEVE
PARLAMENTARE

26

AKTIVITETET E
KRYETARIT DHE
DEPUTETËVE

Ku ishte Kryetari i
Kuvendit?

Cilat ishin aktivitetet e
Deputetëve?

27

TRANSPARENCA E
KUVENDIT

28

PËRFUNDIM DHE
REKOMANDIME

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Legjislatura e tetë e Kuvendit të Kosovës ushtroi vep-
rimtarinë e saj në një kontekst politik me zhvillime të
ndryshme të brendshme dhe të jashtme. Si rëndom **zhvil-**
limet në procesin e dialogut Kosovë-Serbi ndikuan edhe
dinamikat brenda Kuvendit. Në vitin e dytë të Legjislaturës,
më 7 nëntor 2022, deputetët e Listës Serbe dhanë
dorëheqje, një vendim që ndodhi paralelisht me dorëheqjet
e zyrtarëve të tjerë të këtij komuniteti nga jeta institucio-
nale.

Gjatë periudhës sa zgjati Legjislatura, gjithsej **gjashtë de-**
putetë iu larguan grupit më të madh parlamentar LVV,
ndërsa iu bashkua një deputete nga partitë opozitare. Pa-
varësisht këtyre lëvizjeve të deputetëve, partia në pushtet
arriti të ruante shumicën parlamentare deri në fund të
Legjislaturës dhe të miratonte legjislacionin, duke llogarit-
ur në mbështetjen e partive nga Grupi Multietnik.



Kjo Legjislaturë miratoi Rregulloren e re të Punës pas më shumë se një
dekade diskutimesh, duke u bërë Legjislatura e parë që ndryshoi
Rregulloren. Por, disa projekt propozime si Kodi Civil dhe Projektligji
për shëndet riprodhues dhe dhe fertilizim të asistuar mjekësor,
nuk arritën të kalonin, për shkak të kundërshtimeve të vet deputetëve të
pushtetit.

Për periudhën sa zgjati Legjislatura e tetë, **u mbajtën**
gjithsej 263 seanca, përfshirë seancat plenare, vazhdi-
met, seancat e jashtëzakonshme, seancat solemne dhe të
veçanta. **Mesatarisht, rreth 35% e seancave rezultuan me**

vazhdimet, për shkak të pamundësisë për të përfunduar
të gjitha pikat e rendit të ditës në kohë. Pothuajse, **të gjitha**
seancat u ndërpre në mungesë kuorumi, për shkak se
deputetët i braktisën ato në mes pasi fillimisht ishin nën-
shkruar në listën e pjesëmarrjes, listë kjo në të cilën për
çdo seancë kanë figuruar mbi 90 deputetë.

Kuvendi gjatë kësaj kohe, trajtoi një gamë të gjerë çështjesh
që ndikonin në jetën e qytetarëve dhe proceset institucio-
nale të vendit. **Mes temave më të diskutuara** ishin zhvilli-
met në **dialogun Kosovë-Serbi,** duke përfshirë edhe ato
në pjesën veriore të Kosovës, **rritja e çmimit të energjisë**
elektrike dhe produkteve tjera si dhe efektet e pandemisë
COVID-19.

Kjo Legjislaturë miratoi Rregulloren e re të Punës pas më
shumë se një dekade diskutimesh, duke u bërë Legjislatura
e parë që ndryshoi Rregulloren. Ngjashëm, u miratua
edhe Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike. Por,
disa projekt propozime si Kodi Civil dhe Projektligji për
shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor,
nuk arritën të kalonin, për shkak të kundërshtimeve të vet
deputetëve të pushtetit. Kjo shpërfaqti pikëpamjet ideolog-
jike të deputetëve dhe i la këto çështje pa epilog dhe sf-
iduese për Legjislaturën e radhës.

Sjelljet dhe gjuha jo parlamentare ishin fenomen prezent
edhe gjatë kësaj Legjislature, me disa episode të sharjeve
dhe ofendimeve mes deputetëve dhe ministrave në sean-
ca dhe mbledhje të komisioneve parlamentare. **Kjo sjellje**
kulmoi me përplasjen fizike mes deputetëve dhe min-
istrave në një prej seancave të Kuvendit, ndërsa mun-
guan vendimet sanksionuese të kryetarit të Kuvendit.

Për të saktësuar dhe avancuar tutje
rregullat e sjelljes së deputetëve që
parashihen nga Rregullorja e Punës,
Kuvendi draftoi Kodin e Sjelljes.
Mirëpo, në mungesë të vullnetit
politik ky dokument mbeti pa u
miratuar.

Edhe pse pushteti dhe opozita kishin mospajtime të vazh-
deshme, **Kuvendi arriti konsensus në disa raste,** duke i
mbështetur disa nga vendimet me 2/3 e votave, të tilla si
Rezoluta, qëndrime kundrejt Serbisë etj.

Bojkoti i Listës Serbe nga gjysma e vitit 2022 pengoi
miratimin e disa projektligjeve që kërkonin shumicën e
dyfishtë të votave, si Projektligji për festat zyrtare dhe ai
për vetëqeverisjen lokale. Po ashtu, **nuk u miratuan as tri**
propozim-amendamentet kushtetuese për procesin e
vetingut në drejtësi. Pavarësisht diskutimeve të shumta,
partia në pushtet nuk paraqiti ndonjë alternativë për këtë
çështje, duke e lënë këtë iniciativë pa epilog.



Kuvendi gjatë Legjislaturës së
tetë, miratoi gjithsej **282 ligje.**
Nga këto, **205 janë ligje të**
brendshme që rregullojnë fusha të
ndryshme, ndërsa **77 marrëveshje**
ndërkombëtare, që përbëjnë 29% të
legjislacionit të miratuar.

Gjatë mandatit të kësaj Legjislature, **Kuvendi arriti të**
përbushë mesatarisht 36% të planit legjislativ vjetor.
Kuvendi nuk e arriti asnjëherë zbatimin as të gjysmës
së planit të tij vjetor. Për më tepër, 154 projektligje, që
përbënin 21% të legjislacionit, nuk iu shpërndanë asn-
jëherë deputetëve, ndonëse ishin në planin e punës së
komisioneve. Kjo pasi që draftet nuk u sollën në Kuvend
nga Qeveria.

Në afro katë vitet e kësaj Legjislature, ligjet më të shum-
ta janë miratuar në fushën e drejtësisë, e cila përfaqëson
11% të totalit të ligjeve të miratuara. Pasuar nga, fusha e
administratës dhe procedurave administrative me 10%,
shëndetësisë dhe shëndetit publik me 9%, si dhe bujqë-
sisë dhe blegtorisë me 8%. Në përfundim të Legjislaturës,

mbetën në procedurë 32 projektligje, nga të cilat 14 kanë
kaluar shqyrtimin e parë në Kuvend, ndërsa 18 vetëm janë
shpërndarë tek deputetët. **Mes projektligjeve që kanë**
mbetur në procedurë janë edhe 6 marrëveshje ndërkom-
bëtare, të cilat mbetën pa u ratifikuar.

Nga ligjet e miratuara, **16 janë kontestuar dhe dërguar**
në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim. Nga këto, Gjyka-
ta shpalli 3 ligje si të pavlefshme dhe 3 të tjera pjesër-
ishtë në përputhje me Kushtetutën, duke treguar nevojën
për ndryshime në disa nene për t'u përafëruar me stan-
dardet kushtetuese. Nga ana tjetër, 4 ligje kaluan testin
kushtetues dhe hynë në fuqi, ndërsa për 6 të tjera aktgjy-
kimet ende janë shpallur.

U mbajtën gjithsej 36 debate parlamentare dhe 6 inter-
pelanca, ndërsa deputetët parashtruan mbi **603 pyetje**
parlamentare ndaj Kryeministrit Kurti dhe anëtarëve të
kabinetit të tij. Qeveria u përgjigj në 501 prej tyre, ndërsa
nuk ofroi përgjigje në 17% të pyetjeve që iu drejtuan.

14 komisionet parlamentare të Kuvendit realizuan 1674
aktivitete. Prej tyre, 1291 ishin mbledhje për projektligje
dhe tema të tjera, ndërsa organizuan 77 dëgjime publike,
3 dëgjime mbikëqyrëse dhe 27 tryeza diskutimi. **Komis-**
ioni për Ekonomi kryesoi me 205 aktivitete, ndjekur nga
Komisioni për Buxhet me 167 aktivitete dhe Komisioni për
Legjislacion me 138 aktivitete të realizuara.

Komisionet parlamentare **nisën mbikëqyrjen e zbatimit**
të 29 ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Nga këto, rapor-
tet për 14 ligje u miratuan nga komisionet, por **vetëm 6**
raporte arritën të miratoheshin në seancat e Kuvendit.
Ndërkohë, 15 iniciativa mbetën vetëm në fazën e krijimit
të grupeve punuese në komisione, pa arritur të avancohen
më tej.



Kuvendi themeloi 6 komisione hetimore gjatë Legjislaturës së tetë, që përfaqësojnë 40% të gjithë komisioneve hetimore të krijuara që nga themelimi i Kuvendit. Megjithatë, këto komisione nuk arritën të përfundonin punën e tyre me miratimin e raporteve përfundimtare në seancat e Kuvendit.



Gjatë Legjislaturës së tetë, transparenca e Kuvendit ndaj publikut nuk ishte në nivelin e duhur. Megjithëse, seancat u transmetuan live, transmetimi i mbledhjeve të komisioneve mbeti në vullnetin e portaleve informative. **Seancat u mbajtën në mungesë të sistemit elektronik, të cilin Kuvendi nuk arriti ta rikthente deri në fund të Legjislaturës, në sesionin vjeshtor 2024. Si rezultat, deputetët votuan vazhdimisht me dorë, ndërsa Kuvendi nuk ishte transparent në publikimin e mënyrës së votimit të deputetëve.**

Gjatë Legjislaturës së tetë, transparenca e Kuvendit ndaj publikut nuk ishte në nivelin e duhur. Megjithëse, seancat u transmetuan live, transmetimi i mbledhjeve të komisioneve mbeti në vullnetin e portaleve informative. Seancat u mbajtën **në mungesë të sistemit elektronik**, të cilin Kuvendi nuk arriti ta rikthente deri në fund të Legjislaturës, në sesionin vjeshtor 2024. Si rezultat, **deputetët votuan vazhdimisht me dorë, ndërsa Kuvendi nuk ishte transparent në publikimin e mënyrës së votimit të deputetëve.**

Po ashtu, **nuk u ndërморën hapa për rregullimin e lobi-mit në ligjvënien**, megjithëse ishte parashikuar në Planin e Veprimit për Kuvend të Hapur. Transparenca mungoi edhe në publikimin e rregulltë dhe të plotë të dokumenteve nga

ana e Kuvendit, si planet dhe raportet e punës, raportet e përditësuara financiare dhe një pjesë e procesverbaleve nga aktivitetet e komisioneve. Kuvendi publikoi 80% e procesverbaleve të mbledhjeve të komisioneve, ndërsa 20% mbetën të pa publikuara. Nga dokumentet e tjera, si planet e punës, raportet e punës dhe raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, vetëm 4 nga 14 komisionet parlamentare i publikuan disa nga këto dokumente. Kurse, raporti financiar i fundit i publikuar nga Kuvendi është i gjashtëmu-jorit 2023.



HYRJE

Ky raport ofron një analizë dhe vlerësim të detajuar të performancës së Legjislaturës së tetë të Kuvendit të Kosovës, gjatë kohëzgjatjes nga marsi 2021 deri në dhjetor 2024. Legjislatura kjo, e cila është e para që nga shpallja e pavarësisë, që ka përfunduar mandatin e plotë katërvjeçar.

Raporti është rezultat i monitorimit të vazhdueshëm, si fizik ashtu edhe elektronik, nga ana e Institutit Demokratik të Kosovës dhe përfshin monitorimin direkt të seancave plenare, mbledhjeve të komisioneve dhe aktiviteteve të tjera parlamentare. Burimet sekondare që kanë shërbyer në këtë analizë përfshijnë të dhënat zyrtare të publikuara nga Kuvendi, siç janë lajmet, procesverbalet dhe transkriptet, ndërsa një pjesë e të dhënave është mbledhur gjithashtu përmes komunikimit të drejtpërdrejtë me administratën e Kuvendit.

Raporti ofron një pasqyrë të zhvillimeve kryesore që ndodhën gjatë kësaj Legjislature, duke vlerësuar cilësinë e funksionit legjislativ, mbikëqyrjen ndaj ekzekutivit dhe transparencën e Kuvendit. Përmes këtij raporti, shpalosen edhe aktivitetet e deputetëve dhe të kryetarit të Kuvendit, puna e komisioneve parlamentare dhe efikasiteti i Kuvendit në realizimin e detyrave të tij kushtetuese dhe ligjore.

Në pjesën e parë të raportit, theksohen disa nga çështjet kryesore që kanë dominuar seancat plenare të Kuvendit, të tilla si mungesa e kuorumit, mungesa e një Kodi të Sjelljes dhe sjelljet jo-parlamentare. Raporti gjithashtu ofron një vlerësim të ligjvënies, duke pasqyruar natyrën e ligjeve të miratuara dhe diskutimet e zhvilluara gjatë procesit të miratimit të tyre. Kontestimet e ligjeve në Gjykatën Kushtetuese dhe shqetësimet lidhur me përputhshmërinë e disa prej tyre me Kushtetutën janë gjithashtu pjesë e shqyrtimit.

Një pjesë e rëndësishme e raportit i dedikohet mbikëqyrjes që Kuvendi ka ushtruar ndaj ekzekutivit. Kjo përfshin vlerësimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe kontrollit, duke përfshirë pyetjet parlamentare, debatet parlamentare dhe interpelancat. Vëmendje të veçantë i kushtohet edhe aktiviteteve të komisioneve parlamentare dhe rolit të tyre në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe hetimin e çështjeve të ndryshme, përmes komisioneve hetimore. Raporti gjithashtu vë në pah aktivitetet e brendshme dhe të jashtme të Kuvendit.

Një tjetër aspekt që është përfshirë në këtë analizë është transparenca e Kuvendit. Raporti shqyrton masat që Kuvendi ka marrë për të siguruar informimin e publikut, si dhe për të garantuar llogaridhënien. Në përfundim, raporti ofron rekomandime për Kuvendin dhe deputetët, duke theksuar mangësitë dhe sfidat që duhen adresuar në Legjislaturën e ardhshme, për të përmirësuar procesin ligjvënës, për të fuqizuar rolin mbikëqyrës dhe për të rritur efikasitetin dhe transparencën e punës parlamentare.



KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e mbajtura më 14 shkurt 2021, rezultuan me përbërjen e re të përfaqësimit në Kuvendin e Kosovës. Një muaj pas, më 22 mars u konstituua Legjislatura e re e Kuvendit, e teta me radhë me kryetarin nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje,



Glauk Konjufca
dhe nënkryetarët



Saranda Bogujevci (Vetëvendosje), Bedri Hamza (PDK), Kujtim Shala (LDK), Sllavko Simiq (LS) dhe Bekim Arifi (komunitetet e tjera jo serbe).

Në të njëjtën ditë në një seancë të jashtëzakonshme u zgjodh edhe Qeveria e Republikës së Kosovës me Kryeministër Albin Kurtin. Ndërsa, me 4 prill kjo Legjislaturë zgjodhi edhe Presidenten e vendit, Vjosa Osmani-Sadriun, në raundin e tretë të votimit. Kjo, pasi në raundin e parë dhe të dytë ajo nuk kishte arritur të merrte votat e nevojshme.

Grupi më i madh parlamentar Lëvizja Vetëvendosje (ku përveç deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje bëjnë pjesë edhe deputetë nga partia Guxo dhe partia Alternativa), e nisi këtë Legjislaturë të Kuvendit me 58 deputetë. Përgjatë katër viteve grupit parlamentar të LVV-së, iu larguan gjashtë deputetë, ndërsa iu bashkëngjiti një deputete. Ishte, deputetja Adelina Grainca e cila aderoi në LVV nga grupi parlamentar i PDK-së në fillim të Legjislaturës, në prill të vitit 2021, gjatë procedurës së zgjedhjes së Presidentes së vendit. Ndërsa, më shumë se një vit më pas, në shtator 2022, deputetja Doarsa Kica- Xhelili, kaloi në grupin parla-

mentar të LDK-së, pas mospajtimeve të shprehura lidhur me mënyrën se si partia në pushtet po drejtonte reformën në drejtësi.

Gjatë vitit 2023, nga grupi i LVV-së u larguan dy deputetë tjerë. Në shkurt u largua edhe deputeti Haki Abazi, pas përplasjeve verbale me shefen e grupit parlamentar Mimoza Kusari-Lilën dhe koordinatoren e LVV-së Dejona Mihailin. Ndërsa, në mars deputeti Fatmir Humolli, lëshoi grupin, pas publikimit të audio-incizimeve mes Mimoza Kusarit Lilës dhe Milan Radojiciq ku dëgjohej dakordimi mes tyre për të votuar Ligjin për pagën minimale që përjashtonte veteranët e UÇK së nga lista e pagave. Të dy këta deputetë vazhduan veprimtarinë e tyre në Kuvend si të pavarur.

Në vitin e fundit të kësaj Legjislature, në tetor të vitit 2024, grupit parlamentar të LVV-së iu larguan edhe tre deputetë, Drita Millaku, Visar Korenica dhe Eman Rrahmani. Dy të fundit, prej shumë kohësh, kishin shfaqur pakënaqësitë e tyre, sidomos lidhur me Projekt Kodin Civil të propozuar nga Qeveria, një nen i të cilit mundësonte martesat e të njëjtës gjini. Pas shkëputjes nga LVV, dy deputetët i janë bashkuar koalicionit AKR- PD nën emërimin, Koalicioni për Familjen. Ndërsa, deputetja Drita Millaku, pas largimit i është bashkuar subjektit politik LDK, ndërsa publikisht nuk ka shprehur arsyet e saj për këtë vendim.

Pavarësisht lëvizjeve të deputetëve, Lëvizja Vetëvendosje, partia në pushtet, arriti të ruante shumicën parlamentare, duke marrë mbështetje nga partitë e komuniteteve jo shumicë, përveç Listës Serbe. Kjo siguroi vazhdimësinë e punës së Kuvendit dhe miratimin e ligjeve dhe akteve të tjera të nevojshme deri në përmbylljen e kësaj legjislature. Ndërkohë, ndonëse shumica parlamentare nuk ka përfshirë asnjë koalicion me partitë e tjera shqiptare, ka pasur përplasje të shpeshta të brendshme dhe kundërshtime nga disa deputetë të saj për projektligje të caktuara.



Kjo Legjislaturë ushtroi veprimtarinë e saj në një kontekst politik me zhvillime të ndryshme të brendshme dhe të jashtme. **Gjatë kësaj Legjislature u miratua edhe Rregullorja e re e Punës së Kuvendit, dokument ky i cili nuk ishte ndryshuar nga asnjë legjislaturë paraprake për më shumë se 10 vite.**

Si rëndom zhvillimet në procesin e dialogut Kosovë-Serbi ndikuan edhe dinamikat brenda Kuvendit. **Në vitin e dytë të Legjislaturës, përkatësisht më 7 nëntor 2022,** deputetët e Listës Serbe dhanë dorëheqje, zhvillim ky që paralelisht kishte dorëheqjet e pjesëtarëve të komunitetit serb nga të gjitha institucionet publike. Paraprakisht, deputetët e kësaj partie kishin filluar me bojkotim të punimeve të Kuvendit që nga muaji i fundit i sesionit pranveror 2022.

Disa ditë më vonë, më 17 nëntor, u betuan deputetët e rinj, por edhe ata vazhduan ta bojkotojnë Kuvendin e Kosovës, duke marrë pjesë në punimet e Kuvendit vetëm çdo gjashtë muaj, për të shmangur humbjen e përhershme të mandateve. Ndërkohë, Lista Serbe arriti të bëjë zëvendësimin e vetëm nëntë deputetëve, duke humbur kështu një mandat. Kjo shënon herën e parë që një subjekt politik – në këtë rast Lista Serbe – humb një mandat deputeti për shkak të pamundësisë për ta zëvendësuar atë.

Në fund të Legjislaturës, me 5 dhjetor, deputetët e kësaj partie erdhën si rëndom çdo 6 muaj në Kuvend për tu nënshkruar në seancë. Mirëpo kësaj radhe, ata u penguan që të marrin pjesë në seancë nga deputetët e VV-së dhe kryetari Glauk Konjufca, i cili ndërpreu seancën për të pamundësuar pjesëmarrjen e tyre. Kjo pasi fillimisht e cilësoi si të turpshme dhe të patolerueshme sjelljen e kësaj part-

ie. Ky veprim i Kryetarit Konjufca, përbënte cenim të mandatit kushtetues të deputetit, sepse sipas ligjit, deputetët i nënshtrohen vetëm ndërgjegjes së tyre. Andaj edhe bojkoti – si mjet politik – ndonëse e dobëson efikasitetin e Kuvendit dhe cenon përfaqësimin e interesave të qytetarëve, nuk mund të përdoret si arsye për pengim të pjesëmarrjes së deputetëve në punimet e Kuvendit.

ECURIA E PUNËS PARLAMENTARE

Zhvillimet në Kryesi



Kryesia e Kuvendit, që është përgjegjëse për organizimin e seancave të Kuvendit, gjatë mandatit të kësaj Legjislature, **mbajti gjithsej 93 mbledhje** (26 mbledhje në 2021, 26 në 2022, 22 në 2023 dhe 19 në 2024).

Në fakt, 124 mbledhje ishin të planifikuara, por 31 prej tyre apo 25% dështuan në mungesë të kuorumit (8 mbledhje dështuan në vitin 2021, 9 në 2022, 10 në 2023 dhe 4 në 2024). Vetëm në fund të vitit 2021, 4 mbledhje të njëpasnjëshme të Kryesisë dështuan. Ngjashëm edhe 3 mbledhje gjatë gjysmës së parë të vitit 2023. Ky ishte edhe viti kur dështuan më së shumti mbledhje të Kryesisë, gjithsej 31% e tyre.


Në rastet kur mungoi kuorumi në Kryesi, kryetari i Kuvendit në përputhje me kompetencat e tij caktoi vetë mbajtjen e seancave 13 herë. Kryesisht, mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit u zhvilluan në frymën e bashkëpunimit dhe konsensusit në planifikimin e seancave. Megjithatë, shpeshherë përplasjet politike me partitë opozitare, për tema të ndryshme, reflektuan edhe në atmosferën e punës në Kryesi, duke rezultuar kështu me dështimin e disa prej mbledhjeve. Kjo pasi nënkryetarët e partive opozitare shpeshherë nuk morën pjesë në këto mbledhje.

Tutje, edhe pse sipas Rregullores së Kuvendit, Kryesia duhet të miratojë kalendarin e punimeve njëmuore të Kuvendit, i cili publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit, kjo praktikë nuk u zbatua as gjatë kësaj Legjislature. Si rezultat, Kuvendi zhvilloi punën me kalendar kryesisht ditor dhe javor, duke reflektuar një planifikim të dobët të punës dhe një mungesë të qartësisë në organizimin e aktiviteteve parlamentare.

Zhvillimet në Seanca

Gjatë afro katër viteve të kësaj Legjislature janë mbajtur **gjithsej 263 seanca** (57 seanca në 2021, 88 në 2022, 74 në 2023 dhe 44 në 2024), duke përfshirë këtu seancat plenare, seancat e jashtëzakonshme, vazhdimet e seancave, seancat solemne dhe seancat e veçanta. Gjatë vitit 2022, janë mbajtur më së shumti seanca, vit ky që mund të konsiderohet viti më produktiv i kësaj Legjislature, në raport edhe me sasinë e ligjeve të miratuara.

Mesatarisht **35% të seancave të mbajtura kanë prodhuar edhe vazhime të seancave**, pasi nuk kanë është arritur të përfundohen pikat e planifikuara të rendit të ditës.



Pothuajse gjatë gjithë kësaj Legjislature, sistemi elektronik në Kuvend ka munguar, duke bërë që deputetët të votojnë manualisht me dorë. Kjo ka çuar në vonesa gjatë seancave dhe në ecuri të ngadaltë të procesit legjislativ, duke krijuar një sfidë për menaxhimin efikas të punimeve të Kuvendit. Gjithashtu, ka pasur raste kur, për shkak të sfidave në numërim, deputetët kanë hedhur dyshime mbi saktësinë e numërimit të votave me dorë, çka ka shtuar më tej pasiguri në procesin parlamentar. Vetëm në seancën e fundit të legjislaturës, sistemi elektronik i votimit është rregulluar, duke theksuar se ky problem ka mbetur i pazgjidhur për shumicën e periudhës, duke ndikuar negativisht në efikasitetin e punës parlamentare.

Tri temat më të diskutuara gjatë kësaj Legjislature ishin zhvillimet në dialogun Kosovë-Serbi duke përfshirë edhe ato në pjesën veriore të Kosovës, rritja e çmimit të energjisë elektrike dhe produkteve tjera si dhe efektet e pandemisë COVID-19.

Temat të cilat e karakterizuan vitin e parë të Legjislaturës, veç atyre më lartë, ishin propozimet nga programi i Qeverisë 2021-2025, reciprociteti i targave të automjeteve në kuadër të dialogut me Serbinë, pensionet, gjendja në arsim, falja e gjobave gjatë pandemisë, , rimëkëmbja ekonomike, puna 100 ditore e Qeverisë etj. Një nga temat e nxehta ishte edhe projektligji për pagat, për të cilin tri partitë opozitare kërkonin procedimin e tij sa më të shpejtë në Kuvend. Lidhur me krizën energjetike gjatë dimrit, Qeveria prezantoi vendimin për shpalljen e gjendjes emergjente, i cili u miratua nga Kuvendi, por u kritikua nga opozita si vendim i vonshëm.

Ndërsa, vitin 2022 Kuvendi e filloi me një seancë të jashtëzakonshme lidhur me synimet e Serbisë për të mbajtur referendum kushtetues në territorin e Republikës së Kosovës, i cili u kundërshtua nga të gjitha partitë parlamentare, me përjashtim të Listës Serbe. Përveç kësaj çësht-

je, temat tjera që u diskutuan në seanca gjatë këtij viti ishin ngritja e çmimeve të produkteve, shtrenjtimi i energjisë elektrike nga ZRRE, pandemia COVID, lufta Rusi-Ukrainë, mos liberalizimi i vizave, dërgimi i FSK-së a jashtë vendit, greva e Sindikatës së arsimit, zgjatja e masave emergjente në furnizim me energji, targat e automjeteve në Veri etj.

Në gjysmën e këtij viti, në korrik, Kuvendi mori një nga vendimet më të rëndësishme, **miratoi Rregulloren e re të Punës, e cila nuk ishte ndryshuar nga asnjë legjislaturë paraprake për më shumë se një dekadë.** Po ashtu, po këtë vit u miratua edhe Projektligji për Financimin e Subjekteve Politike, që ishte në pritje të miratimit që nga viti 2018, e i cili kishte për qëllim avancimin e transparencës dhe llogaridhënies financiare të subjekteve politike.

Gjatë këtij viti Kuvendi miratoi edhe Strategjinë e Sigurisë së Kosovës 2022-2027, por me kundërshtime nga opozita, e cila e kritikoi mos përfshirjen e komenteve të tyre në përmbytje të Strategjisë.



Viti 2022 ishte viti, kur u prezantua për herë të parë dhe të vetme para deputetëve Projekt Kodi Civil. I njëjti nuk u mbështet nga një pjesë e deputetëve të pushtetit dhe të opozitës, për shkak të një neni i cili rregullonte martesat mes të njëjtës gjini. Kështu, në shqyrtimin e parë të këtij Projekt Kodi, **vetëm 28 deputetë votuan 'për'.** **Mungesa e miratimit të Kodit Civil, i pamundëson Kosovës kodifikimin e procedurës civile dhe është në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të drejtave civile.**



Gjatë këtij viti u shfaq një praktikë e re e zvarritjes së themelimit të komisioneve hetimore nga ana e partisë në pushtet, ku për pasojë opozita lëshoi sallën plenare në disa raste. Fillimisht, nuk u mbështet krijimi i komisionit hetimor për menaxhimin e krizës energjetike, ndërsa një vit pas ngjashëm edhe komisioni për hetimin e rezervave shtetërore.

Viti 2023, i kësaj Legjislature filloi me miratimin e Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, një nga ligjet më të diskutuara në kuadër të reformës në drejtësi. Në pjesën e parët të vitit 2023, Kuvendi miratoi dy dokumente të rëndësishme, Strategjinë e Energjisë për periudhën 2022-2031 dhe Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2023-2027.

Ngjashëm si në rastin e Projekt Kodit Civil, deputetët nuk mbështetën as Projektligjin për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizimin të Asistuar Mjekësor, i cili iu shpërnda deputetëve në fillim të vitit 2023. Problematike shihej pjesa e Projektligjit që iu mundësonte grave të realizonin shtatzëni përmes dhuruesve anonim dhe pa partner. Pas shumë zvarritjeve i njëjti, u mbështet në shqyrtim të parë gjatë vitit 2024, por mbeti i pa miratuar në fund të Legjislaturës.

Në gjysmën e dytë të vitit 2023, ndodhi një nga ngjarjet më negative të kësaj Legjislature – përplasja fizike mes deputetëve dhe ministrave. Kjo thelloi tutje polarizimin mes pushtetit dhe opozitës, i cili pasoi me refuzimin e opozitës për të votuar marrëveshjet ndërkombëtare. Në kundërpërgjigje, **Kryeministri Albin Kurti vendosi të mos u përgjigjej pyetjeve parlamentare të deputetëve deri në votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.**

Viti 2024 e gjeti këtë Legjislaturë me mospajtime të mëdha mbi tema, si faturimi i energjisë elektrike me çmim të lartë, situata në shëndetësi, kontratat një burimore të Qeverisë, procesi i subvencionimit për blerjen e teksteve shkollore, komunikimet e **Mimoza Kusari Lilës me Milan Radojciq,**



ushqimi në FSK, përllogaritja e borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, menaxhimi në KEK, bordi i RTK-së, etj.

Përveç mospajtimeve pothuajse të vazhdueshme mes pushtetit dhe opozitës, në disa raste Kuvendi gjatë kësaj Legjislature kishte **qëndrim konsensual**, duke mbështetur me 2/3 e votave vendime si, ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale, Rezolutën për Srebrenicën, Rezolutën për referendumin e Serbisë në Kosovë, Rezolutën në mbështetje të Ukrainës, miratimin e Rregullores së re të Kuvendit, miratimin e projektligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, rezolutën që dënonte sulmin terrorist të organizuar nga Serbia në veri të Kosovës më 24 shtator 2023, Deklaratën e BE-së për Dialogun Kosovë-Serbi, Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2023-202 dhe Deklaratën për mbështetjen e Rezolutës së OKB-së për gjenocidin në Srebrenicë.

Në anën tjetër, ndonëse kishte një konsensus fillestar për draftimin e legjislacionit për vetingun në drejtësi, pasi përfundoi punën komisioni ad-hoc gjithëpërfshirës, partia në pushtet dhe partitë opozitare u përballen me komente gjatë shqyrtimit të këtyre amendamenteve nga Gjykata e Kushtetuese.

Tutje, bojkoti i Listës Serbe nga gjysma e vitit 2022, e pamundësoi miratimin e disa projektligjeve për të cilat nevojitej shumica e dyfishit, si Projektligji për festat zyrtare dhe Projektligji për vetëqeverisjen lokale, të cilat Kuvendi tentoi t'i miratonte gjatë vitit 2021 dhe 2022. Për të njëjtën arsye nuk arritën të miratohen as tri propozim-amendamentet kushtetuese për zhvillimin e procesit të vetingut në drejtësi. Lidhur me këtë, partia në pushtet nuk prezantoi ndonjë alternativë tjetër për vetingun në drejtësi, duke e lënë këtë çështje të shumë diskutuar pa ndonjë epilog.



Në mungesë të kuorumit

Fjala më e shpeshtë e dëgjuar gjatë kësaj Legjislature ishte ajo e kryesuesit të Kuvendit për mungesën e kuorumit, fenomen ky që ndërpreu në mes pothuajse çdo seancë të kësaj Legjislature. Si rezultat, në disa prej seancave janë votuar dhjetëra ligje përnjëherë, e në raste edhe me procedura të përsheptuara. **E tillë ishte seanca e 5 dhjetorit në fund të kësaj Legjislature, e cila u karakterizua me veprime të partisë në pushtet, të cilat ishin në kundërshtim me parimet demokratike dhe të qeverisjes së mirë.**

Në një anë ka pasur një numër të madh të mungesave nga ana e deputetëve dhe në anën tjetër edhe kur disa prej deputetëve kanë qenë prezent në seancat e Kuvendit, pjesëmarrja e tyre ka figuruar vetëm në letër, por jo edhe në punimet e Kuvendit. Kështu, në listën e evidencës zyrtare të Kuvendit ku nënshkruhen deputetët, për çdo seancë kanë figuruar më shumë se 90 deputetë. Këto veprime të deputetëve dëshmojnë papërgjegjësinë e tyre kundrejt pjesëmarrjes në punimet e Kuvendit, në përputhje me Rregulloren e Punës dhe legjislacionin në fuqi. Ndërsa, nuk ka munguar gatishmëria për tu regjistruar në listën e evidencës, si kusht për të përfituar mëditjet për pjesëmarrje në seancë.

Derisa partitë opozitare mund ta kenë përdorur braktisjen e seancave, si mjet politik për t'ia pamundësuar partisë në pushtet kuorumin e nevojshëm për miratim të ligjeve, mbetet e pakuptueshme mos prezenca e rregullt e deputetëve të partisë në pushtet. Kjo sepse, kjo e fundit e ka përgjegjësinë kryesore për sigurimin e kuorumit minimal për miratimin e ligjeve me shumicë të thjeshtë, përjashtimisht rasteve të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkom-

1 Shih Nenin 40 dhe 41 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit në, <https://shorturl.at/jlLV0>

2 Shih aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese pika 80 dhe 83 në https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ko_29_11_shq.pdf



bëtare, ku nevojiten 2/3 e votave dhe rrjedhimisht edhe prezenca e deputetëve nga radhët e opozitës.


Sidoqoftë, deputetët, pa dallim partie, e kanë obligim pjesëmarrjen në punimet e Kuvendit ashtu siç e parasheh Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit si dhe Rregullorja e Kuvendit. Ky ligj përcakton ndalesë të kompensimit për deputetët që nuk marrin pjesë në seanca apo komisione për shkaqe të paarsyeshme. Tutje aty thuhet që “Deputeti është i detyruar të marrë pjesë në seancat plenare dhe në mbledhjet e organeve ndihmëse të Kuvendit, në të cilat ai është anëtar dhe nëse ai për një arsye nuk mund të marrë pjesë, duhet të njoftojë me kohë kryetarin e Kuvendit dhe të prezantojë arsyet e mungesave. Nëse deputeti nuk merr pjesë në punimet e seancës plenare ose të organeve ndihmëse të Kuvendit, ku ai është anëtar, paga bazë dhe kompensimi shtesë reduktohen¹.

Këtë e ka sqaruar përfundimisht edhe Gjykata Kushtetuese, në rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit lidhur me zgjedhjen e Presidentit i datës 22 shkurt 2011. Aty Gjykata ka theksuar se të gjithë 120 deputetët e Kuvendit duhet të ndjehen të obliguar sipas Kushtetutës, Ligjit për Deputetët, Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të sjelljes të marrin pjesë në seancat plenare të Kuvendit dhe të përkrahin procedurat që parashihen aty, por mbi të gjitha, kanë obligim vis-a-vis qytetarëve të Kosovës që i zgjedhën ata².

Derisa ka pasur deputetë që janë nënshkruar dhe kanë qëndruar në seanca dhe të tillë që janë nënshkruar dhe kanë braktisur seancat në mes, disa prej deputetëve nuk kanë ardhur fare në disa prej seancave të Kuvendit.




|||||



Përgjatë kësaj Legjislature, deputetët e Kuvendit kanë bërë mbi 5 mijë mungesa (789 gjatë vitit 2021, 1490 në vitin 2022, 1608 gjatë vitit 2023 dhe 1155 mungesa në vitin 2024). Kështu, në 200 seanca gjatë kësaj Legjislature, për të cilat Kuvendi mbajti evidencë, numri i mungesave ishte 21%. Në bazë të grupeve parlamentare, përqindja më e lartë e mungesave është e Listës Serbe, gjithsej 1611 apo 32%, pasur nga LVV me 27% (1361 mungesa), PDK me 16% (795 mungesa), LDK me 14% (729 mungesa), Grupi Multietnik 5% (259 mungesa), AAK 5% (256 mungesa) dhe Deputetët e pavarur 1% (37 mungesa).

Përqindja e mungesave gjatë Legjislaturës së tetë, sipas grupeve parlamentare



Numrin e përgjithshëm të mungesave e ka rritur bojkoti i subjektit politik Lista Serbe, e cila nuk ka marrë pjesë në punimet e Kuvendit që nga mesi i vitit 2022. Deputetët e kësaj partie, kanë ardhur vetëm për tu nënshkruar pasi i janë afruar 6 mujorit të mospjesëmarrjes, gjë që do të rezultonte me humbje

|||||

të mandateve. Ngjashëm kanë vepruar edhe dy deputetët tjerë të afërm me këtë subjekt politik, Adem Hodza dhe Fadil Gashi që përfaqësojnë grupet tjera minoritare.

Pa Kod të Sjelljes, e me sjellje jo parlamentare

Gjuha dhe sjelljet jo parlamentare kanë qenë të shpeshta gjatë kësaj Legjislature si në seanca ashtu edhe në komisione parlamentare, pa dallim partie. Në vitin 2023 ato kulmuan me përplase fizike në mes të deputetëve e ministrave, rast ky i cili përfundoi në Gjykatë dhe përfundoi me marrëveshjen e ndërmjetësimit mes palëve të përfshira.

Rregullorja e Kuvendit sanksionon gjuhën dhe sjelljet jo parlamentare në Kuvend, megjithatë zbatimi i dispozitave nga ana e Kryetarit të Kuvendit si interpretues i Rregullores, në shumicën e rasteve ka munguar.

Me qëllim avancimin tuje të legjislacionit që përcakton rregullat e sjelljes së deputetëve, me 6 tetor të vitit 2022, në Komisionin për Legjislacion u formua grupi punues për hartimin e Kodit të Sjelljes. Për draftimin e këtij dokumenti, komisioni realizoi vizita studimore në SHBA dhe në Shqipëri.

Pas dy viteve, me 27 shkurt 2024, grupi punues, përfundoi draftimin e Kodit të sjelljes për deputetët, i cili kishte për qëllim të adresojë aspekte të sjelljes së deputetëve, gjuhës jo-parlamentare, veshjeve zyrtare dhe veprimeve të ndaluara të deputetëve. Ndonëse, fillimisht sanksionet e parapara financiare ishin në vlerë 2% e më pas 20% të pagës bazë të deputetit, në mbledhjen e komisionit me 30 prill 2024, në të cilën u miratua Projekt Kodi, u propozua rritja e tyre deri në 50%. Gjatë shqyrtimit në seancë, më 12 shtator, ky dokument u tërhoq dhe iu kthye mbrapa Komisionit për Legjislacion për rishikim për shkak, siç u deklarua, disa mospajtimeve për disa nga dispozitat e Projekt Kodit. **Që nga ajo kohë, Projekt Kodi i Sjelljes nuk u trajtua më në seanca të Kuvendit, dhe në fund të Legjislaturës ai mbeti i pa miratuar.**

Ndonëse, Kodi i Sjelljes do të rregullonte më në detaje sjelljen dhe etikën parlamentare, dispozitat që përcaktojnë rregullat e sjelljet e deputetëve janë të shpërndara në Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Si të tilla kanë qenë të mjaftueshme për të sanksionuar sjelljet jo-parlamentare, porse ka munguar zbatimi nga ana e Kryetarit të Kuvendit.


|||||

|||||

LIGJVËNIA DHE NATYRA E LIGJEVE TË MIRATUARA

Gjatë mandatit të plotë të kësaj Legjislature, Kuvendi përmbushi mesatarisht **36%** të planit legjislativ. Në vitin e parë, në 2021, u përmbush **18%** e planit, ndërsa në vitin 2022, ishte më i lartë, gjithsej **48%**. Në vitin pasues, në 2023, Kuvendi përmbushi **39%** të planit legjislativ, ndërsa në vitin e fundit, në 2024, u realizua **37%** e planit. Krahimisht, përmbushja e planit legjislativ ishte më e lartë vetëm gjatë vitit 2022. Kurse, Kuvendi nuk arriti asnjëherë të realizonte as gjysmën e planit të tij legjislativ vjetor.

Në anën tjetër, 154 projektligje apo 21% e legjislacionit, nuk arritën të iu shpërndahen asnjëherë deputetëve edhe pse ishin në planet e punës së komisioneve, për shkak se Qeveria nuk i solli draftet në Kuvend.



³ Në vitin e parë të Legjislaturës, në 2021, më së shumti u miratuan Ligje në fushën e shëndetësisë dhe shëndetit publik, 22% e ligjeve të miratuara gjatë këtij viti ishin të kësaj fushe. Në vitin e dytë, në 2022, Kuvendi miratoi më së shumti ligje në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, me 16% të ligjeve të miratuara që i përkasin kësaj fushe. Kurse në vitin 2023, ishte fusha e drejtësisë ajo në të cilën u miratuan më së shumti ligje, me gjithsej 20%. Viti i fundit i Legjislaturës, viti 2024, u karakterizua me më shumë ligje të miratuara në fushën e administratës, me gjithsej 13% t tilla, të cilat rregullojnë aspekte të ndryshme administrative.

|||||

Vlen të theksohet, se plani legjislativ i Kuvendit çdo vit është i shpërndarë në planet e punës së komisioneve parlamentare, në mungesë të vazhdueshme të një plani gjithëpërfshirës dhe të konsoliduar vjetor.

Në aspekt të numrit të ligjeve të miratuara, në këtë Legjislaturë u miratuan **gjithsej 282 Ligje**, prej tyre **205** Ligje të brendshme që rregullojnë fusha të ndryshme (22 ligje në 2021, 84 në 2022, 55 në 2023, 44 në 2024) dhe **77 Marrëveshje ndërkombëtare** (14 marrëveshje në 2021, 27 në 2022, 16 në 2023 dhe 20 në 2024). „që përbëjnë **27% të legjislacionit** të miratuar gjatë kësaj Legjislature. Vlen të theksohet se, 85 nga Ligjet e miratuara ishin plotësim-ndryshime, ndërsa 120 Ligje të reja.

Për shkak se gjatë gjithë Legjislaturës mungoi sistemi elektronik në Kuvend, deputetët votuan me dorë. Nga ana e Kuvendit nuk u publikua asnjëherë lista me informacione se si votuan deputetët, veprim ky në kundërshtim me Rregulloren. Publikimi i mënyrës së votimit të deputetëve nuk u bë as në sesionin e fundit të Legjislaturës, kur sistemi elektronik u rikthye në Kuvend.

Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të procedurës penale, ishte i pari i miratuar nga kjo Legjislaturë në vitin 2021. Ndërsa, më së shumti Ligje dhe Marrëveshje janë miratuar në vitin e dytë të Legjislaturës, në 2022.

Sa i përket fushave të cilat mbulojnë ligjet e miratuara, nëse shikohet pasqyra e përgjithshme e katër viteve të kësaj Legjislature, **më së shumti ligje u miratuan në fushën e drejtësisë, me gjithsej 11% të ligjeve të miratuara që i përkasin kësaj fushe**. Pasuar nga, 10% ligje në fushën e administratës dhe procedurave administrative, 9% në fushën e shëndetësisë dhe shëndetit publik, dhe 8% janë ligje që rregullojnë fushën e bujqësisë dhe blegtorisë³. Ndërsa,



në përqindje më të ulët janë ligjet e miratuara në fusha tjera si transporti, financa, turizmi, telekomunikatet.

Gjatë gjithë Legjislaturës, procedura e përsheptuar dhe shpallja nga afatet procedurale të Rregullorës u aplikua në 27 raste, e shoqëruar me kritikë nga partitë opozitare lidhur me përmbajtjen e projektligjeve të shqyrtuara dhe faktin që Qeveria nuk po merrte parasysh propozimet e tyre. Zakonisht këto procedura u aplikuan në fund të sesioneve të punës, veçanërisht në fund të Legjislaturës.

Vetëm në seancën e 5 dhjetorit, 15 Projektligje u miratuan me shpallje nga afatet procedurale. Kjo praktikë e ktheu Kuvendin hap më mbrapa dhe ishte një goditje ndaj vlerave demokratike dhe qeverisjes së mirë.

Në fund të Legjislaturës së tetë, 32 Projektligje mbetën në procedurë (26 Projektligje dhe 6 Marrëveshje ndërkombëtare). 14 prej tyre kaluan shqyrtimin e parë në Kuvend, ndërsa 18 arritën vetëm tu shpërndahen deputetëve. Vlen të theksohet se disa prej këtyre projektligjeve nuk kanë arritur të miratohen për shkak të nevojës për shumicën e dyfishtë në Kuvend, konkretisht votat e deputetëve të komuniteteve. Të tilla janë projektligji për festat zyrtare, për vetëqeverisjen lokale, për arsimin e lartë dhe ai për lirinë fetare. Pas zgjedhjeve të reja që do të mbahen në shkurt 2025, këto Projektligje kthehen në pikën zero dhe varet nga vullneti i Qeverisë dhe Legjislaturës së re nëse do të procedojnë sërish të njëjtat Projektligje në Kuvend.

Kjo Legjislaturë ka pa ratifikuar 6 marrëveshje ndërkombëtare të rëndësishme si ajo e financimit për programin e zhvillimit ekonomik, anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat të Bankës Botërore, dhe të tjera që do të ndihmonin përmirësimin e sektorëve kyç si energjia, shëndetësia, dhe arsimi.

Dështimi për t'i miratuar këto marrëveshje tregon një mungesë të theksuar angazhimi nga ana e kësaj Legjislature për të mbështetur përpjekjet e Kosovës për integrim më të thellë në institucionet ndërkombëtare dhe zhvillimin e saj ekonomik e social. Tani që ka përfunduar Legjislatura, proceduralisht këto marrëveshje kthehen në pikën zero, ndërsa nuk dihet nëse Qeveria e re do të procedojë të njëjtat sërish në Legjislaturën e re, apo nëse shtetet dhe institucionet me të cilat janë arritur marrëveshjet do t'i vazhdojnë të njëjtat.

Nëse krahasohet me Legjislaturat paraprake, Legjislatura aktuale renditet në vendin e parë për nga sasia e ligjeve të miratuara në raport me kohëzgjatjen e saj, me gjithsej 6.27 ligje të miratuara për muaj. Pasuar nga Legjislatura e tretë dhe e katërt e Kuvendit (Tabela 1.1).



Sa i përket përfshirjes qytetare në procesin ligjvënës, gjatë kësaj Legjislature, komisionet parlamentare kanë organizuar gjithsej 77 dëgjime publike, për 63 Projektligje, me pjesëmarrës përfaqësues institucional, grupe të interesit dhe organizata të shoqërisë civile. Në raport me 205 ligjet e miratuara, kjo nënkupton që diskutime publike u organizuan për vetëm 31% të legjislacionit.


Sipas Nenit 81 të Rregullorës së Kuvendit, komisionet parlamentare mund të organizojnë seanca dëgjimore me qëllim marrjen e vërejtjeve dhe mendimeve nga institucione, persona ose grupe të interesuara dhe për Projektligjin e Buxhetit Vjetor. Por, një praktikë e tillë u aplikua vetëm një herë nga ana e Komisionit për Administratë, konkretisht lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.

4 Komunikatë për Media e KDI-së, 5 dhjetor 2024, në <https://shorturl.at/cz21Y>



Tabela 1.1: Krahasimi mes legjislaturave nga aspekti i numrit të ligjeve të miratuara, në raport me kohëzgjatjen

Legjislatura	Periudha e veprimit	Kohëzgjatja	Gjithsej ligje të miratuara	Mesatarja e ligjeve të miratuara në muaj	Marrëveshje ndërkombëtare	Plotësim-ndryshime	Ligje të reja
I	17.11.2001-23.11.2004	36 muaj	84	2.33	0	10	74
II	23.11.2004-12.12.2007	37 muaj	79	2.14	0	37	42
III	13.12.2007-03.11.2010	34 muaj	205	6.03	0	39	166
IV	12.12.2010-07.05.2014	41 muaj	220	5.37	18	48	154
V	17.07.2014-10.05.2017	34 muaj	115	3.38	26	28	61
VI	03.08.2017-22.08.2019	25 muaj	109	4.36	29	24	56
VII	26.12.2019-06.01.2021	13 muaj	17	1.31	12	1	4
VIII	22.03.2021-15.12.2024	45 muaj	282	6.27	77	85	120






Kontestimi i ligjeve në Gjykatën Kushtetuese



Gjatë kësaj Legjislature, **32 ligje të miratuara në Kuvend (3 në 2022, 8 në 2023, 21 në 2024)** janë kontestuar dhe dërguar në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë, me kërkesë kryesisht të partive opozitare, por edhe nga institucione të tjera. **16 prej tyre janë dërguar nga PDK** vetëm në muajin e fundit të Legjislaturës, për shkak të miratimit të tyre me procedurë të përshpejtuar me datën **5 dhjetor**. Përveç tyre, partitë opozitare kanë kërkuar verifikimin e **12 ligjeve**, ndërsa **2** prej tyre janë dërguar nga Avokati i Popullit, **1** nga Gjykata Supreme dhe **1** ligj nga Kryetari i Prizrenit Shaqir Totaj.

Ligjet e kontestuara mbulojnë fusha të ndryshme, përfshirë sistemin e drejtësisë (Ligji për Këshillin Prokurorial dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale), administratën publike (Ligji për Zyrtarët Publikë dhe Shërbimin Civil, Ligji për Paga) tregun (Ligji për masat e përkohshme të produkteve themelore), menaxhimin e pasurisë (Ligji për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme), fiskalitetin (Ligji për Tatimin në Pronë dhe Fondin Sovran), investimet e qëndrueshme, zgjedhjet etj.



Nga këto 16 ligje të kontestuara, Gjykata Kushtetuese i ka shpallur 3 ligje të pavlefshme dhe 3 të tjera pjesërisht në përputhje me Kushtetutën. Kjo tregon se, ndërsa disa ligje janë gjetur të papajtueshme me Kushtetutën, ka pasur edhe ligje që kërkojnë ndryshime në nene të caktuara për të qenë në përputhje me standardet kushtetuese. Nga ana tjetër, 4 ligje kanë kaluar testin kushtetues dhe janë konsideruar në përputhje me Kushtetutën, duke u mundësuar kështu hyrjen e tyre në fuqi. Për 22 ligje të tjera, Gjykata ende nuk ka shpallur aktgjykimet.

Së fundi, në nëntor 2024, edhe Presidentja e Republikës ka ushtruar të drejtën e vetos dhe ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend dy ligje, duke kërkuar që Kuvendi të bëjë përshtatje. Sipas zyrës së Presidentes, ligji i parë rrezikonte sigurinë kombëtare dhe është në kundërshtim me Kushtetutën, ndërsa i dyti kishte dispozita që mund të dëmtojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve, dy të drejta që janë të garantuara në Kushtetutë. Kuvendi nuk arriti të ti trajtonte vërejtjet e Presidentës brenda afatave të përcaktuara me Rregullore duke pamundësuar hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve.



MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Gjatë funksionimit të Legjislaturës së tetë, u mbajtën **gjithsej 36 debate parlamentare** (8 debate në vitin 2021, 13 në 2022, 8 në 2023 dhe 7 në 2024). **Më së shumti debate parlamentare ka iniciuar grupi parlamentar i PDK-së**, me gjithsej 14 të tilla, pasuar nga AAK me 10 dhe LDK me 9 debate të iniciuara. Temat kryesore lidhur me të cilat u zhvilluan debatet ishin, pandemia COVID 19 dhe efektet e saj si dhe çmimi i energjisë elektrike.

Përveç partive opozitare, tri debate parlamentare u iniciuan edhe nga partia në pushtet, dy prej të cilave nga vet Kryeministri Albin Kurti, njëri prej tyre për ecurinë e procesit të dialogut me Serbinë dhe tjetri rreth synimeve të Serbisë për mbajtjen e referendumit në Kosovë. Vlen të theksohet se kryeministri inicioi debate parlamentare vetëm në fillim të Legjislaturës, në gjysmë të vitit 2021 dhe në fillim të vitit 2022. Ndërsa, gjatë vitit 2023, një herë në fillim të viti dhe një herë në fund, ai kishte dy raportime para Kuvendit, të dy këto lidhur me zhvillimet në procesin e dialogut Kosovë-Serbi.

Përveç debateve parlamentare, në Kuvend gjatë kësaj Legjislaturë u mbajtën edhe 6 interpelanca (2 në vitin 2021, 3 në vitin 2022 dhe 1 në vitin 2023). Të gjitha këto interpelanca u iniciuan nga grupi parlamentar i AAK-së, 4 prej të cilave ishin ndaj Ministrit Hekuran Murati, 1 me Kryeministrin Albin Kurti dhe 1 me Ministrin e Brendshëm Xhelal Sveçla.

Gjatë periudhës katërvjeçare, deputetët parashtuan në seanca 603 pyetje parlamentare ndaj Kryeministrit Kurti dhe ministrave të kabinetit të tij⁵. Partia në pushtet parashtroi afroi gjysmën e pyetjeve parlamentare (49%) të parashtuara gjatë kësaj Legjislature. Konkretisht, LVV parashtroi 293 pyetje, pasuar nga PDK me 186 pyetje, AAK me 89 pyetje, LDK me 28 pyetje dhe Grupi Multietnik që parashtroi 14 pyetje.

Tabela 1.2: Pyetjet parlamentare të parashtuara në seanca sipas grupeve parlamentare


LVV	293
PDK	186
AAK	89
LDK	28
GRUPI MULTIETNIK	7
GJITHSEJ	603

Deputetët e Kuvendit që parashtuan më së shumti pyetje në seanca ishin, Bekim Haxhiu (PDK) me 47 pyetje, Mirlinda Tishukaj Sadiku (VV) dhe Time Kadriaj (AAK) me nga 38 pyetje të parashtuara. Deputetja Ganimete Musliu (PDK) parashtroi 31 pyetje ndërsa, deputetet Arjeta Fejza (VV) dhe Ariana Musliu-Shoshi (PDK) secila parashtuan nga 28 pyetje.

Tabela 1.3: Deputetët që parashtuan më së shumti pyetje parlamentare në seanca

Bekim Haxhiu (PDK)	47 pyetje
Mirlinda Tishukaj-Sadiku (VV)	38 pyetje
Time Kadriaj (AAK)	38 pyetje
Ganimete Musliu (PDK)	31 pyetje
Ariana Musliu-Shoshi (PDK)	28 pyetje

5 Në këtë numër pyetjesh janë të përfshira vetëm ato që deputetët i kanë parashtuar gjatë seancave ndaj kryeministrit dhe ministrave. Ky numër mund të jetë më i lartë, pasi deputetët para se t'i lexojnë pyetjet në seanca, i dorëzojnë ato në zyrën e Kuvendit për parashtrës. Disa pyetje nuk janë parashtuar gjatë seancave, edhe pse janë dorëzuar atje, për shkak të mungesës së deputetëve që i kanë dorëzuar ato, ose për arsye të tjera.



Kryeministri Kurti dhe ministrat e kabinetit u përgjigjën me shumë vonesa në 501 prej pyetjeve që iu parashtuan në seanca, apo në 83% prej tyre, ndërsa në 17% prej tyre nuk ishin prezent në seanca apo refuzuan të përgjigjen.

Në sesionin vjeshtor të vitit 2023, vet Kryeministri Kurti deklaroi se nuk do të iu përgjigjet asnjë prej pyetjeve parlamentare të deputetëve të opozitës, duke i kushtëzuar me votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, një veprim ky i paprecedent që cënoi rolin mbikëqyrës të Kuvendit.

Në përgjithësi, më së shumti pyetje parlamentare iu drejtuan ministrit të Mjedisit Liburn Aliu, gjithsej 120 të tilla. Pasuar nga Kryeministri Kurti të cilit iu drejtuan 77 pyetje, ministrës së Arsimit Arbërie Nagavci 68 pyetje, ministrit të Kulturës Hajrulla Çeko 56 pyetje dhe ministrit të Financave Hekuran Murati 55 pyetje. Pjesa tjetër e pyetjeve iu parash-trua ministrave të tjerë.

Tabela 1.4: Anëtarët e kabinetit qeverisës që iu drejtuan më së shumti pyetje parlamentare

Liburn Aliu	Ministër i Mjedisit	120 pyetje
Albin Kurti	Kryeministër	77 pyetje
Arbërie Nagavci	Minstre e Arsimit	68 pyetje
Hajrulla Çeko	Ministër i Kulturës	56 pyetje
Hekuran Murati	Ministër i Financave	55 pyetje

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, gjatë periudhës 4 vjeçare komisionet parlamentare iniciuan mbikëqyrjen e zbatimit të 29 ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Më së shumti iniciativa për mbikëqyrje kishte nga Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Ekonomi.

Megjithë këto iniciativa për mbikëqyrje, komisionet kanë mbikëqyrur zbatimin e vetëm 14% të ligjeve të miratuara. Nga këto, vetëm për 7 ligje, ose 3%, janë paraqitur dhe miratuar raportet e mbikëqyrjes në seanca, duke reflek-tuar një angazhim të pamjaftueshëm të komisioneve për mbikëqyrjen efektive të zbatimit të ligjeve.

Në anën tjetër, nga këto 29 iniciativa për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve, raportet e mbikëqyrjes u miratuan nga komisionet parlamentare vetëm për 13 ligje, ndërsa prej tyre vetëm 7 raporte të mbikëqyrjes arritën të miratohen edhe në seancë të Kuvendit. Në anën tjetër, gjysma e inicia-tivave për mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve, apo 15 gjithsej, mbetën vetëm në nivel të krijimit të grupeve punuese nëpër komisione, pa përfunduar procedurat e mbikëqyrjes.

Prezenca dhe raportimi i ministrave në Komisione Parlamentare

Sa i përket mbikëqyrjes nga komisionet parlamentare, ministrat e kabinetit qeveritar gjatë katër viteve të Leg-jislaturës së tetë, ishin prezent 226 herë në mbledhjet e komisioneve apo në 18% të mbledhjeve. Prej tyre, 126 herë, apo në 10% të mbledhjeve ata erdhën në komisione për të raportuar për punën e tyre, kurse 100 herë apo në 8% të mbledhjeve ishin për të prezantuar projektligje të reja apo vendime tjera qeveritare.

Në aspekt krahasimor, më së shumti në mbledhje të komisioneve ka qenë Ministri i Financave Hekuran Mu-rati gjithsej 50 herë, pasuar nga Ministrja e Ekonomisë Artane Rizvanolli, 26 herë. Ndërsa, nga 21 herë ishin zëvendëskryeministri Besnik Bislimi dhe Ministrja e Ar-simit Arbërie Nagavci.

Duhet të theksohet se dy ministra të Qeverisë Kurti, ai për Komunitete dhe Kthim Nenad Rašić dhe Zëvendëskryem-inistre e tretë për Çështje të Pakicave dhe Drejtat e Njeriut Emilija Redžepi nuk ishin asnjëherë prezent në komisionet e Kuvendit. Ndërsa, rrallëherë ishin edhe ministrat tjerë të komuniteteve si Elbert Krasniqi, i cili brenda 4 viteve ishte vetëm 5 herë dhe Fikrim Damka që ishte vetëm 2 herë.

Në anën tjetër, ishin Komisioni për Ekonomi dhe Komisioni për Buxhet në mbledhjet e të cilëve ishin më së shumti prezent ministrat, pasuar nga Komisioni për Arsim dhe ai për Integrim Evropian.

Mbikëqyrja përmes komisioneve hetimore

Në funksion të mbikëqyrjes, Kuvendi gjatë kësaj Legjislature, themeloi gjithsej 6 komisione hetimore. Kjo përbën 40% të të gjitha komisioneve hetimore të krijuara që nga themelimi i Kuvendit, që ishin gjithsej 15 komisione të tilla. Por, puna e asnjërit prej komisioneve hetimore të themel-uara këtë Legjislaturë nuk u përmyll me miratim të raporteve përfundimtare hetimore. Kjo ishte, fatkeqësisht, në linjë me trendin e zakonshëm të legjislaturave para-prake, ku gjithsej vetëm çereku i komisioneve hetimore, apo vetëm 3 prej tyre, kanë arritur t’a përmyllin mandatin e tyre me miratim të raportit përfundimtar në seancë të Kuvendit.

Tabela 1.5: Komisionet hetimore të themeluara gjatë Legjislaturës së tetë

Data	Tema
05.05.2022	Menaxhimin e krizës energjetike nga Qeveria e Republikës së Kosovës
05.05.2022	Procesin e vendimmarrjes në sektorin e energjisë për periudhën 2006-2022, në nivelin legjislativ, ekzekutiv, rregullator dhe në ndërmarrje publike.
07.06.2023	Rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje në Republikën e Kosovës
21.09.2023	Hetimin e procedurave për furnizimin dhe menaxhimin me rezervat shtetërore
07.03.2024	Punësimet në shërbimin e jashtëm dhe zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës
04.04.2024	Për procesin e subvencionimit të blerjes së teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore për vitin shkollor 2023/2024

Komisionet hetimore si rëndom, edhe gjatë kësaj Legjislature u përballën me sfida të shumta, përfshirë, vështirësitë në arritjen e kuorunit për shkak të bojkotimit të punës nga partia në pushtet dhe hetimet paralele në çështjet penale. Puna e tyre ishte e pasuksesshme, dhe u shfrytëzua më shumë si një mekanizëm për luftë politike midis partive. Për tu evituar disa nga këto sfida, është i nevojshëm ndry-shimi i Ligjit për Hetim Parlamentar, disa mangësi në të cilin po pamundësojnë funksionimin e mirëfilltë të komi-sioneve hetimore.

14 komisionet parlamentare të Kuvendit, përgjatë këtyre 4 viteve realizuan gjithsej **1674 aktivitete** (364 në vitin 2021, 499 në vitin 2022, 464 në vitin 2023 dhe 347 në 2024). Prej tyre, **1291 ishin mbledhje** gjatë të cilave u trajtuan projektligje dhe tema tjera në bazë të fushëveprimit të komisioneve. Veç tyre, komisionet realizuan edhe 77 dëgjime publike,

14 komisionet parlamentare të Kuvendit, përgjatë këtyre 4 viteve realizuan gjithsej **1674 aktivitete** (364 në vitin 2021, 499 në vitin 2022, 464 në vitin 2023 dhe 347 në 2024). Prej

tyre, **1291 ishin mbledhje** gjatë të cilave u trajtuan projektligje dhe tema tjera në bazë të fushëveprimit të komisioneve. Veç tyre, komisionet realizuan edhe 77 dëgjime publike,

3 dëgjime mbikëqyrëse dhe 27 tryeza diskutimi. Po ashtu mbajtën, 164 takime me përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtarë, 75 vizita në terren në institucione dhe komuna si dhe 27 vizita dhe takime jashtë vendit. Siç dëshmojnë statistikatat, dy vitet në mes të Legjislaturës, 2022 dhe 2023, ishin më produktive në raport me realizimin e më shumë aktiviteteve nga komisionet.

sionet tjera që renditën pas tij, janë Komisioni për Buxhet me gjithsej 167 aktivitete dhe ai për Legjislacion me 138 aktivitete. Ndërsa me më pak aktivitete të realizuara gjatë kësaj Legjislature janë, Komisioni për mbikëqyrjen e AKI-së me 59 aktivitete, pasuar nga Komisioni për Komunitete me 65 aktivitete. (Shih tabelën 1.6)

Në aspekt krahasimor, është Komisioni për Ekonomi i udhëhequr nga deputeti Ferat Shala, ai që ka realizuar më së shumti aktivitetet përgjatë 4 viteve, me **205 gjithsej**. Kom-

Komisionet Parlamentare		Mbledhje	Dëgjime Publike	Dëgjime Mbikëqyrëse	Takime	Proces-verbale	Takime virtuale	Intervista/ Konkurse	Vizita në terren	Vizita jashtë vendit	Tryeza	Gjithsej
1	Ekonomi	150	22	2	12	172	0	0	16	1	2	205
2	Buxhet	162	4	0	1	156	0	0	0	0	0	167
3	Legjislacion	117	3	0	6	112	1	6	0	5	0	138
4	Drejtat e njeriut	89	6	0	17	92	0	0	14	4	6	136
5	Arsim	89	18	0	5	85	0	2	17	2	2	135
6	Integrim	87	0	0	26	87	0	0	2	3	5	123
7	Mbikëqyrjen e Financave	111	0	0	1	106	0	0	1	1	0	114
8	Shëndetësi	94	4	0	12	102	0	0	0	0	5	115
9	Mjedis	94	6	0	5	91	0	0	3	0	4	112
10	Siguri	82	3	0	15	26	0	0	7	4	0	111
11	Administratë	82	11	1	3	63	0	0	0	1	1	97
12	Punë të Jashtme	32	0	0	56	74	0	0	0	5	2	95
13	Komunitete	57	0	0	3	57	0	0	5	0	0	65
14	Mbikëqyrjen e AKI-së	45	0	0	2	0	1	0	10	1	0	59
Gjithsej		1291	77	3	164	1223	2	8	75	27	27	1674

Komisionet Parlamentare		Mbledhje	Dëgjime Publike	Dëgjime Mbikëqyrëse	Takime	Proces-verbale	Takime virtuale	Intervista/ Konkurse	Vizita në terren	Vizita jashtë vendit	Tryeza	Gjithsej
1	Ekonomi	150	22	2	12	172	0	0	16	1	2	205
2	Buxhet	162	4	0	1	156	0	0	0	0	0	167
3	Legjislacion	117	3	0	6	112	1	6	0	5	0	138
4	Drejtat e njeriut	89	6	0	17	92	0	0	14	4	6	136
5	Arsim	89	18	0	5	85	0	2	17	2	2	135
6	Integrim	87	0	0	26	87	0	0	2	3	5	123
7	Mbikëqyrjen e Financave	111	0	0	1	106	0	0	1	1	0	114
8	Shëndetësi	94	4	0	12	102	0	0	0	0	5	115
9	Mjedis	94	6	0	5	91	0	0	3	0	4	112
10	Siguri	82	3	0	15	26	0	0	7	4	0	111
11	Administratë	82	11	1	3	63	0	0	0	1	1	97
12	Punë të Jashtme	32	0	0	56	74	0	0	0	5	2	95
13	Komunitete	57	0	0	3	57	0	0	5	0	0	65
14	Mbikëqyrjen e AKI-së	45	0	0	2	0	1	0	10	1	0	59
Gjithsej		1291	77	3	164	1223	2	8	75	27	27	1674




AKTIVITETET E KRYETARIT DHE DEPUTETËVE

Ku ishte Kryetari i Kuvendit?

Gjatë katër viteve të Legjislaturës së tetë, Kryetari i Kuvendit Glauk Konjufca, veç detyrave të tij primare në kryesimin e seancave dhe mbledhjeve të kryesisë realizoi edhe aktivitete tjera në kuadër të fushëveprimit të tij.


Numëruar gjithsej, kryetari gjatë kësaj periudhe zhvilloi **495 aktivitete brenda dhe jashtë vendit**. Prej tyre, 300 apo 61% e aktiviteteve ishin takime zyrtare në Kuvend me përfaqësues vendor, ambasadorë e përfaqësues tjerë ndërkombëtarë ndërsa, 4% e aktiviteteve apo 21 ishin vizita jashtë vendit. Përveç tyre, Konjufca mori pjesë edhe në 74 ngjarje brenda vendit si tryeza, konferenca e evente tjera, që përbëjnë 15% të aktiviteteve. Ndërsa, 21% e aktiviteteve të Kryetarit apo 100 prej tyre ishin homazhe përkujtimore në zona të ndryshme të vendit. Rrjedhimisht, takimet me përfaqësues vendor dhe ndërkombëtarë në Kuvend përbëjnë përqindjen më të lartë të aktiviteteve të kryetarit Konjufca, pasuar nga homazhet përkujtimore.



Cilat ishin aktivitetet e Deputetëve?

Veç kryetarit edhe disa prej deputetëve të Kuvendit zhvilluan një numër të aktiviteteve gjatë periudhës sa zgjati kjo Legjislaturë. Gjithsej, ata zhvilluan 265 aktivitete, pa përfshirë këtu aktivitetet në kuadër të komisioneve parlamentare, të cilat u elaboruan më lartë. Përqindjen më të lartë të aktiviteteve të deputetëve, apo 40%, e përbëjnë vizitat zyrtare jashtë vendit, përfshirë këtu pjesëmarrjen në organizime atje. Tutje, 27% e aktiviteteve kanë qenë takime brenda vendit me përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtarë, 15% pjesëmarrje në organizime të ndryshme brenda vendit, 12% takime dhe debate me qytetarë, ku në mesin e tyre kryesisht takime me nxënës të shkollave dhe studentë. Dhe në fund, 6% e aktiviteteve të deputetëve përfshijnë pjesëmarrjen në mënyrë virtuale në takime të institucioneve ndërkombëtare dhe konferenca të ndryshme.

Është e rëndësishme të theksohet se aktivitetet e përshkruara të deputetëve por edhe Kryetarit janë ato që janë raportuar nga Kuvendi në faqen e tij zyrtare. Mund të ketë aktivitete të tjera, veçanërisht takime me qytetarë apo organizime nga shoqëria civile, në të cilat kryetari ose deputetët kanë marrë pjesë, por që nuk janë pasqyruar në faqen zyrtare të Kuvendit.



TRANSPARENCA E KUVENDIT

Gjatë Legjislaturës së tetë, Kuvendi nuk qëndroi mirë sa i përket transparencës ndaj publikut. Ndonëse, seancat u transmetuan live në televizionin publik, transmetimi i mbledhjeve të komisioneve mbeti në vullnetin e televizioneve dhe portaleve.

Tutje, mungesa e sistemit elektronik në Kuvend pamundësoi identifikimin e mënyrës së votimit nga ana e deputetëve. Ndonëse, regjistrimi elektronik u rikthye në Kuvend në sesionin e fundit vjeshtor, të vitit 2024, Kuvendi vazhdoi të mos publikonte votat e deputetëve, ndonëse obligohet nga Rregullorja e Punës. Ngjashëm edhe për votat me dorë, Neni 61, pika 9 e Rregullorës së Punës përcakton që publikimi i votimit me dorë bëhet publike brenda dy (2) ditë pune pas përfundimit të votimit në seancë plenare. Kjo gjë nuk u zbatua nga ana e Kuvendit.

Kuvendi nuk ndërmori hapa që të rregullonte as çështjen e lobimit në procesin ligjvënës⁶ edhe pse këtë e kishte listuar si një nga objektivat në Planin e Veprimit për Kuvend të Hapur⁷. Përgjatë, kohës sa zgjati kjo Legjislaturë pati disa zotime nga përfaqësues të partive parlamentare për të eksploruar mundësitë e rregullimit të lobimit⁸, mirëpo fundi i Legjislaturës e gjeti Kuvendin pa ndonjë hap konkret në këtë drejtim.

Sa i përket publikimit të dokumenteve si raportet për punën e Legjislaturave të Kuvendit, në faqen zyrtare të

Kuvendit figurojnë vetëm dy raporte të tilla, ai për Legjislaturën e 5-të dhe raporti i punës për vitin 2023. Tek pjesa e faqes për raportet financiare, Kuvendi ka publikuar raportet e kësaj Legjislature vetëm për vitin 2021, 2022 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2023.

Tek seksioni i faqes zyrtare lidhur me aktivitetet e transparencës së Kuvendit, aktiviteti i fundit i publikuar nga ana e Kuvendit është i datës 16 shtator 2019. Kurse, sa i përket publikimit të dokumenteve nga punimet e Kuvendit si nga seancat dhe mbledhjet e komisioneve, Kuvendi publikoi transkriptet dhe procesverbalet për të gjitha seancat e mbajtura. Ndërsa, për punën e komisioneve, u publikuan 80% e procesverbaleve nga mbledhjet, dëgjimet dhe takimet e mbajtura gjatë kësaj periudhe.⁹ 20% e procesverbaleve për këto aktivitete nuk janë publikuar nga ana e komisioneve.

Sa i përket dokumenteve tjera, si planet e punës, raportet e punës, raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe të ngjashme, **vetëm 4 nga 14 komisionet parlamentare i kanë bërë publike disa prej këtyre dokumenteve**. Më të rregullt në këtë drejtim ishin vetëm Komisioni për Ekonomi i cili i ka publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit gjithsej 21 dokumente, pasuar nga Komisioni për Mjedis i cili i ka publikuar 12 dokumente. Ndërsa, Komisioni për Legjislacion i ka publikuar vetëm 4 dokumente pasuar nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave me vetëm 2 dokumente të publikuara.

⁶ Shih më shumë lidhur me lobin në analizën e KDI-së "Është koha për Ligj për Lobim në Kosovë", Qershor 2021 në <https://shorturl.at/G0zNQ>
⁷ Shih Planine Veprimit për Kuvend të Hapur 2023-2026, fq.22 në <https://shorturl.at/HtdWm>
⁸ Shih përmbledhjen nga Tryeza e KDI-së, "A ka ardhur koha për Ligjin për Lobim?" 14 dhjetor 2023 në <https://shorturl.at/QPiT9>
⁹ Në këtë përllogaritje nuk është përfshirë Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së, i cili për shkak të natyrës së fushëveprimit nuk publikon asnjë procesverbal të aktiviteteve të tij.





PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

Në përfundim, Legjislatura e tetë e Kuvendit të Kosovës zhvilloi punën në një periudhë me dinamika të ndryshme, e ndikuar nga zhvillimet politike të brendshme dhe të jashtme veçanërisht procesi i dialogut Kosovë-Serbi dhe bojkoti i Listës Serbe. Gjatë kësaj periudhe, pavarësisht se Kuvendi arriti të miratojë një numër të konsiderueshëm ligjesh, ky arritje ishte e kufizuar nga pengesa të shumta, si mungesa e kuorumit dhe mospajtimet e brendshme që ndikuan negativisht në zhvillimin e procesit legjislativ.

Një prej problemeve kryesore që ndikoi efikasitetin e Kuvendit ishte realizimi i planit legjislativ. Me një përmbushje mesatare prej vetëm 36%, Kuvendi dështoi të arrijë objektivat e tij, me përjashtim të vitit 2022 që kishte një realizim më të lartë prej 48%, por pa arritur kurrë një realizim të plotë. Ky bilanc u pasua nga një numër projektligjesh që mbetën të papërfunduara, për shkak të mospajtimeve brenda shumicës parlamentare e disa edhe për shkak nevojës për mbështetje nga komunitete. Pjesa më e madhe e ligjeve që u miratuan ishin në fusha si drejtësia, administrata, shëndetësia e shëndeti publik si dhe bujqësia dhe blegtoria.

Puna e komisioneve hetimore, ndonëse në numër ishte më e lartë se në legjislaturat e kaluara, nuk arriti të përfundonte me miratimin e raporteve përfundimtare, duke lënë pa epilog disa hetime të rëndësishme. Gjithashtu, sjelljet jo parlamentare, përfshirë ofendimet dhe përplasjet fizike mes deputetëve dhe ministrave, theksuan një mungesë të disiplinës dhe etikës parlamentare, ndërsa Kryesia e Kuvendit nuk mori masa të mjaftueshme për të adresuar këto incidente. Kodi i Sjelljes, i cili synonte avancimin e rregullave të sjelljes së deputetëve, nuk u miratua për shkak të mungesës së vullnetit politik.

Në anën tjetër, Kuvendi i Kosovës edhe gjatë kësaj Legjislature u përballë me sfida të tjera si transparencja dhe llogaridhënia. Edhe pse seancat plenare u transmetuan rregullisht, kjo nuk ndodhi edhe me mbledhjet e komisioneve. Po ashtu, mungesa e një sistemi elektronik të votimit pamundësoi identifikimin e mënyrës së votimit nga ana e deputetëve ndërsa Kuvendi nuk e publikoi asnjëherë votimin me dorë. Tutje, mospublikimi i dokumenteve të rëndësishme, si raportet e punës dhe financiare, e bëri më

të vështirë monitorimin dhe vlerësimin e punës së Kuvendit nga publiku. Ky lloj i mungesës së transparencës, duke përfshirë këtu edhe dështimin për të rregulluar lobimin në ligjvënien nënvizon se ende ka nevojë për reforma dhe përmirësime në këtë fushë.

Në fund, mungesa e konsensusit të brendshëm, mungesa e efikasitetit në miratimin e legjislacionit dhe problemet e vazhdueshme me disiplinën parlamentare dhe transparencën janë çështje që kërkojnë një vëmendje të menjëhershme për të siguruar një Kuvend më funksional në të ardhmen.

Duke marrë për bazë zhvillimet gjatë kësaj Legjislature, KDI ofron rekomandimet e mëposhtme për tu adresuar gjatë Legjislaturës së ardhshme. Këto rekomandime synojnë përmirësimin e efikasitetit, fuqizimin e rolit mbikëqyrës dhe rritjen e transparencës së Kuvendit.

Planifikimi më i mirë i punës: Kuvendi duhet të përmirësojë planifikimin e punës duke rritur numrin e seancave dhe duke shmangur periudhat pa seanca. Agjendat e seancave duhet të jenë më realiste dhe të menaxhueshme, me një numër të kufizuar pikash dhe seanca që janë të shpërndara më mirë gjatë kalendarit të punës. Po ashtu, **krijimi i një kalendarit mujor** të detajuar do të ndihmonte në shmangien e ngarkesës dhe do të garantonte një punë më të strukturuar. Për më tepër, Kuvendi duhet të hartojë çdo vit një **plan legjislativ gjithëpërfshirës** për të siguruar një punë më të organizuar dhe efikase.

Pjesëmarrja e rregulltë e Deputetëve në punimet e Kuvendit: Deputetët duhet të tregojnë përgjegjshmëri për pjesëmarrjen e plotë në seanca dhe qëndrimin deri në përfundimin e tyre. Kryetari dhe Kryesia duhet të zbatojnë Rregulloren dhe të kërkojnë llogaridhënie nga deputetët që mungojnë pa arsye ligjore. Për të zgjidhur problemin e kuorumit, Kuvendi duhet të sigurojë saktësi në të dhënat e pranisë fizike në seanca dhe të vendosë sanksione financiare për mungesat pa arsye, duke parandaluar abuzimin me mëditjet dhe përmirësuar funksionimin e Kuvendit.

Roli më aktiv i Kryetarit: Kryetari i Kuvendit duhet të jetë më proaktiv në menaxhimin e seancave, duke siguruar që



ministrat dhe Kryeministri të përgjigjen rregullisht në pyetjet e deputetëve. Ai duhet të japë vërejtje dhe të ndërmarë masa ndaj atyre që shmangin përgjigjet, duke siguruar një nivel më të lartë transparence dhe përgjegjshmërie në Kuvend. Për më tepër, Kryetari duhet të zbatojë Rregulloren e Kuvendit dhe të vendosë sanksione për sjelljet jo parlamentare, duke krijuar një mjedis më të rregullt dhe të respektueshëm gjatë punimeve të Kuvendit.

Fuqizimi i mbikëqyrjes Parlamentare ndaj Ekzekutivit: është thelbësor për përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës. Deputetët duhet të jenë më të angazhuar në parashtrimin e pyetjeve parlamentare, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre partiake, duke u fokusuar në çështjet që prekin drejtpërdrejt mirëqenien e qytetarëve. Po ashtu, ata duhet të iniciojnë më shumë debate parlamentare dhe interpelanca, si dhe të kërkojnë raportime të rregullta nga ekzekutivi në seanca dhe komisione.

Mbikëqyrje më e madhe e zbatimit të Ligjeve: Kjo çështje duhet të jetë një prioritet për Kuvendin. Statistikat tregojnë një numër të vogël të ligjeve që janë mbikëqyrur, duke theksuar nevojën për një angazhim më të madh të komisioneve në këtë drejtim. Kuvendi duhet të forcojë mekanizmat e mbikëqyrjes dhe të sigurojë që ligjet të zbatohen siç është parashikuar.

Ndryshim i Ligjit për Hetim Parlamentar: Legjislatura e ardhshme duhet të iniciojë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Hetim Parlamentar, për të mundësuar efikasitet më të madh të këtyre komisioneve. Ndryshimet duhet të bëhen në aspekte si përbërja e komisionit, për të eliminuar pengesat në funksionim, vendosjen e masave për deputetët që me mungesat e tyre pamundësojnë punën e komisioneve hetimore. Si dhe, saktësimin e çështjes hetimore, duke eliminuar hetimet paralele me organet e drejtësisë.

Adresimi i Sjelljeve Jo-Parlamentare: Kuvendi duhet të veprojë me urgjencë për të adresuar sjelljet jo parlamentare gjatë seancave dhe mbledhjeve të komisioneve. Masat disiplinore duhet të jenë të qarta dhe të zbatohen pa kompromis. Kuvendi duhet të ndërmarrë hapa sa më të shpejtë, fillimisht me një qasje më strikte të interpretimit të Rregullores, duke bërë të mundur ndëshkimin e këtyre sjelljeve. Përplasjet politike që degjenerojnë në dhunë fizike janë të papranueshme për institucionin e Kuvendit,



dhe skenat e dhunshme të ndodhura gjatë kësaj Legjislature nuk duhet të përsëriten më.

Miratimi i Kodit të Sjelljes: Legjislatura e re duhet ta ketë prioritet miratimin sa më shpejt të Kodit të Sjelljes për deputetët, duke vendosur standarde të qarta për sjelljen e tyre gjatë punës parlamentare. Implementimi i këtij Kodi do të kontribuonte në një ambient më të disiplinuar dhe rritjen e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit të deputetëve.

Rritja e Transparencës: Derisa rregullimi i sistemit elektronik është një hap pozitiv, Kuvendi duhet të rikthejë praktikën e publikimit të votave të deputetëve. Po ashtu, në frymën e transparencës Kuvendi duhet të publikojë në mënyrë të rregullt dokumente si planet e punës, raportet e punës, transkriptet dhe procesverbalet nga aktivitetet e komisioneve si dhe raportet e përditësuara financiare. Po ashtu, me qëllim avancimin e transparencës, duhet të publikojë informacione përmbledhëse nga mbledhjet e komisioneve ad-hoc dhe hetimore.

Rregullimi i lobimit legjislativ: Kuvendi duhet të rregullojë çështjen e lobimit në ligjvënie, pasi aktualisht nuk ka një regjistër të aktivitetit lobues dhe as ligj që e rregullon këtë. Është thelbësore që çdo aktivitet lobues të regjistrohet dhe të publikohet për të siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri ndaj publikut.

Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare: Kuvendi duhet të krijojë një qasje bashkëpunuese ndërpartiake për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, duke gjetur një gjuhë të përbashkët që siguron konsensus për çështje të rëndësishme që kanë impakt për jetën e qytetarëve dhe vendin. Ratifikimi i marrëveshjeve duhet të trajtohet me prioritet dhe të mos zvarritet si ka ndodhur deri më tani.

Përfshirja më e madhe e publikut në Procesin Ligjbërës: Kuvendi duhet të rrisë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin ligjbërës, për të siguruar që legjislacioni të jetë i hapur, transparent dhe i përgjegjshëm ndaj nevojave të shoqërisë. Dëgjimet publike dhe konsultimet e gjera janë thelbësore për të mundësuar që të gjitha palët e interesuara të kenë mundësinë të kontribuojnë në hartimin e ligjeve. Komisionet parlamentare duhet të angazhohen më aktivisht në përfshirjen e një spektri të gjerë aktorësh, duke krijuar hapësira për diskutime të hapura dhe për të siguruar që ligjet të pasqyrojnë një konsensus të gjerë dhe të jenë në harmoni me interesat publike.



